REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

TETOR - OCTOBER
2005

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Tetor 2005

Personi i kontaktit: Luiza JANO

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL*.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…… …….13
   d. SEKTORI MONETAR……...……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

*Të dhënat e sektorit fiskal janë të dhëna paraprake
Fiscal sector data are preliminary data.

1. VECORITE KRYESORE :

❖ **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Tetor 2005, arriti ne 107 perqind, duke shenuar nje rritje mujore prej 0.4 përqind, pas rritjes prej 0.9 dhe 0.2 perqind, perkatesisht ne muajt shtator dhe gusht. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Tetor, ishte 3.3 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Sh[illegible] perqind.





Kursi mesatar i kembimit per muajin Tetor 2005, ishte:

- 102.26 leke per dollare
- 122.99 leke per euro



Ne muajin Tetor, monedha vendese, rezultoi me nje mbicmim te lehte kundrejt monedhes europiane, Euros dhe me nje nencmim te lehte kundrejt dollarit amerikan. Sjellja e monedhes sone ne tregun vendas eshte reflektimi i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare si dhe i ndryshimit te normave te depozitave ne valute, ne tregjet financiare vendas.

Gjate muajit Korrik 2005, **normat e interesit te depozitave** 12 mujore ne leke, ne ndryshim nga nje muaj me pare, kane pesuar nje rritje te lehte ne vlere absolute prej 0.17 perqind krahasuar me muajin Qershor. Megjithese politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërise nuk ka ndryshuar, normat e interesit per depozitat ne leke, ne tregun primar dhe ate nderbankar jane ndikuar, ne pjesen me te madhe, nga pakesimi dhe mungesa e likuiditeteve.

Renien me te ndjeshme vjetore gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore dhe 6-mujore, respektivisht me rreth 2.33 perqind dhe 2.29 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



	Korr '04	Gusht '04	Shtat '04	Tet '04	Nent '04	Dhje '04	Jan '05	Shku '05	Mars '05	Prill '05	Maj '05	Qersh '05	Korr '05
12-M	6.39	6.27	6.26	6.13	6.13	5.99	5.81	5.72	5.44	5.22	4.87	3.89	4.06
6-M	6.01	5.85	5.79	5.63	5.58	5.41	5.36	5.18	4.85	4.70	4.41	3.77	3.72
3-M	4.88	4.89	4.83	4.76	4.69	4.48	4.49	4.36	4.16	3.95	3.65	3.08	3.02

Renie te lehte edhe per kete muaj kane pesuar depozitat me afat gjashtemujor, te krahasuara me nje muaj me pare (Qershor '05) me 0.05 perqind dhe normat me afat tremujor me 0.06 perqind, ndersa normat me afat njemujor, kane pesuar nje rritje prej 0.09 perqind.

Gjatë muajit korrik interesat e depozitave në valutë janë rritur thuajse në të gjitha afatet. Në rritjen e normave te interesave në valute, kane ndikuar rritja e interesave libor dhe euribor, politika shtrenguese e ndjekur nga Fed-i, si dhe rritja e konkurrences ne tregun valutor.

Shtrengimi i metejshem i politikes monetare nga Fed-i, pritet të ndikoje në rritjen e interesave libor në tregjet ndërkombetare dhe në rritjen e interesave të depozitave dhe te kredive në usd.

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Tetor 2005, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth 18.2 miliarde leke, ose rreth 43.21 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2005.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 161.49 miliarde leke ose rreth 78.20 perqind e programit vjetor 2005.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 179.7 miliarde leke, ose rreth 72.27 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2005.



❖ **Deficiti i pergjithshem** arriti ne 18,217 milione leke nga 23,150 milione leke te parashikuar per kete periudhe 10-mujore, duke perballuar ne kete menyre kryerjen e shpenzimeve ne kohen e duhur.

❖ **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 78.20 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 80.41 përqind të programimit vjetor;
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 79.63 përqind;
- Të ardhurat jo-tatimore 68.16 përqind e buxhetit vjetor; dhe
- Të ardhurat nga pushteti lokal, 91.79 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 72.27 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 153,571 milione lekë ose rreth 79.63 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 74.50 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 81.65 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve të larta operative dhe te mirembajtjes me rreth 84.96 perqind e buxhetit vjetor.

❖ Bilanci i pagesave

Bilanci i pagesave per muajin Qershor 2005, rezultoi me nje defiçit te pergjithshem prej 4.7 milion dollare. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 16.4 milion dollare;
- suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej rreth 10.9 milion dollare;
- sufiçiti te Llogarise Financiare, prej rreth 62.1 milion dollare;
- bilanci negativ ne "Gabime dhe Harresa neto" prej rreth 61.2 milion dollare.

Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 16.4 milion $ ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 151.5 milion dollare;
- sufiçit prej 21.3 milion dollare ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 12 milion dollare ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 101.8 milion dollare ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.

Në baze kumulative, bilanci i pagesave te 3-mujorit te dyte 2005, rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 2.1 milionë dollare.

Komponentët kyç ishin:

- defiçiti prej 126.1 milionë dollare, në llogarinë korrente,
- sufiçiti prej 18.1 milionë dollare ne llogarine kapitale,
- suficiti prej 152.4 milionë dollare në llogarinë financiare,
- bilanc negativ i gabimeve dhe harresave neto prej 42.3 milionë dollare.

- **Oferta totale e parase**, e matur nga M3 arriti në 545.3 miliardë lekë në fund të muajit korrik, duke shenuar një rritje prje 16 perqind krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, por ky tregues eshte me i ulet ne krahasim me muajin qershor, ku rritja vjetore e ketij treguesi ishte 18 perqind.



Kjo rritje erdhi si pasoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 98 perqind, depozitave ne valute me rreth 26 perqind, depozitave me afat ne leke me rreth 5 perqind dhe rritje te parase jashte sistemit me rreth 11 perqind, krahasuar me nje vit me pare.



Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit korrik, ndryshe nga muaji qershor, e kane patur rritja e depozitave pa afat ne leke, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 5 miliarde leke.

2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit per muajin Tetor pesoi nje rritje prej 0.4 perqind, krahasuar me muajt Shtator dhe Gusht 05, ku ky indeks ishte perkatesisht 0.9 dhe 0.2 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin 0.2 perqind, 0.1 perqind dhe – 0.2 perqind.

Kjo rritje prej 0.4 perqind e indeksit te çmimeve te konsumit per muajin Tetor erdhi si rezultat i rritjes se indeksit te cmimeve te grupit "Hotele, kafene dhe restorant" me 0.7 perqind, ardhur kryesisht nga rritja e cmimit te nengrupit "Sherbime akomodimi" me 26.8 perqind. Rritje per kete muaj pesoi edhe indeksi i cmimeve te grupit "Veshje dhe kepuce" me 0.6 perqind. Brenda ketij grupi rritjen me te madhe e pesuan cmimet e nengrupeve "kepuce" dhe "veshje" si pasoje e afrimit te sezonit dimeror, duke rritur ne kete menyre edhe kerkesen per keto produkte gjate kesaj periudhe.

Ashtu si ne keto 2 – 3 muajt e fundit, edhe kete muaj indeksi i cmimeve per grupin "Ushqime dhe pije joalkolike" pesoi nje rritje prej 0.5 perqind. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes se cmimit per nengrupet "zarzavate perfshire patatet" prej 4.4 perqind, "fruta" 0.6 perqind. Keto rritje jane reflektim i drejtepredrejte i pakesimit te prodhimeve bujqesore vendase ne tregun e brendshem, si rezultat i efekteve sezonale.

Vazhdon te pesoje rritje edhe per kete muaj indeksi i cmimeve per grupin "Qera, uje lende djegese dhe energji", me 0.5 perqind. Vlen te theksohet rritja e cmimit te lendes djegese gaz me 5.6 perqind si burim alternativ i perdorur nga konsumatoret ne kushtet e krizes energjtike qe po kalon vendi yne. Gjithashtu mund te permendim edhe rritjen e "Qerave" me 0.6 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Tetor arriti ne 3.3 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2004 dhe 2005 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nen	Dhj.
2005	3.3	1.8	1.6	1.3	2.0	2.9	1.8	2.3	3.1	3.3		
2004	3.3	4.4	4.0	3.2	2.6	2.9	3.1	2.7	2.0	2.0	2.2	2.2

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, edhe per kete muaj shenoi nje rritje prej 1.2 perqind kundrejt muajit Shtator 2005. Ne fund te muajit Tetor dollari amerikan arriti nivelin 101.99 leke/dollare. Kursi mesatar i kembimit te dollarit ne muajin Tetor arriti ne 102.26 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit per Euron ne muajin Tetor arriti ne 122.99 Leke/Euro duke shenuar nje renie prej 0.7 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ne fund te muajit Tetor Euro u kembye me 123.00 leke.



kundrejt Euros dhe nencmim

se monedha shqiptare eshte

hvlersuar kundrejt monedhes



Vleresimi i monedhes shqiptare Lekut, kundrejt monedhes europiane Euro dhe zhvleresimi kundrejt monedhes amerikane, ne rradhe te pare eshte i lidhur me ecurine e tyre ne tregjet monetare nderkombetare, duke reflektuar sjelljen e tyre ne tregun e brendshem monetar. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje renie mesatare duke arritur ne rreth 1.203 dollare/euro.

Ndersa persa i perket faktoreve te brendshem ne ecurine e monedhes vendase gjate kesaj periudhe mund te permendim: flukset dalese te valutes se huaj, uljen e efektit te faktoreve te turizmit dhe te prodhimeve buqesore vendase si dhe politiken e ndjekur nga bankat per ndryshimin e interesave te depozitave ne valute te huaj.

Interesi i huave 12-mujore edhe per kete muaj pesoi nje rritje prej 0.38 perqind, duke arritur ne 12.00 perqind nga 11.62 perqind qe ishte ne muajin qershor. Nje rritje te konsiderueshme per kete muaj pesoi edhe norma per interesin e huave 6-mujore me 2.68 perqind, krahasuar me muajin qershor. Interesi i huave 6-mujore per muajin korrik arriti ne 13.30 perqind.



Normat e interesit te Bonove te Thesarit per muajin korrik, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin 6.96 perqind, 6.59 perqind dhe 5.16 perqind. Ne ndryshim nga muaji qershor te gjithe normat e interesit te bonove te thesarti per kete muaj pesuan rritje. Mungesa e likuiditeteve, ka bërë që oferta e bankave për blerjen e bonove të thesarit të jetë e kufizuar, në disa raste dhe duke mos plotësuar shumën e emetuar. Konkurrenca në ankande është ulur, duke ushtruar presion për rritje të yield-it.

Interesat mesatare të ponderuara për kredite e dhena në leke gjate muajit korrik, kane pesuar rritje per afatet nen nje vit dhe jane ulur per kredite mbi nje vit. Ata jane ndikuar nga prirja ne rritje e interesave te depozitave ne leke, nga rritja e yield-it te bonove te thesarit, si dhe nga ndryshimi i struktures se kredidhënies sipas bankave të caktuara. Norma mesatare e ponderuar e kredise ne leke, ne korrik arriti ne rreth 13.33 për qind ose 0.74 pike perqindjeje me lart se ne muajin qershor.

Ndryshimi i kahut te sjelljes se normave të interesit në leke, ka filluar të pasqyrohet dhe në tendencen e zgjerimit te diferences midis interesave të depozitave në leke dhe në valute.

b. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Tetor, jane mbledhur rreth 161,499 milione leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 179,715 milione leke, qe perfshijne 153,571 milione leke ne shpenzime korente dhe 26,144 milione leke shpenzime kapitale. Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e 18,2 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave deri ne fund te muajit Tetor, perben rreth 78.20% te totalit te te ardhurave buxhetore te parashikuara per vitin 2005, ndersa shpenzimet perbejne 72.27% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 79.63 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 51.75 % e ketij planifikimi.

Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 108,739 milione leke (ose rreth 80.41 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 9,504 milione leke (91.79 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 29,198 milione leke (79.63 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 11,831 milione leke (68.16 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 153,571 milione leke, 42,091 milone leke (27 %) eshte shpenzuar per personelin, 22,251 milione leke (14 %) per interesat, 18,650 milione leke (12 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 2,847 milione leke (2 %) per subvencione, 45,049 milione leke (29 %) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe 22,684 milione leke (15 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 76.21 % (shpenzime personeli), 74.50 % (shpenzime per interesat), 84.96 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 104.10 % (subvencione), 81.65 % (sigurimet sociale), 82.08 % dhe 79.93 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 26,144 milione leke, nga te cilat 66.67 % financim i brendshem, dhe 33.33 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem, llogariten per kete periudhe ne rreth 62.35 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 38.63 %.

Deficiti prej 18,217 milione leke eshte i barabarte me 43.21 % te deficitit buxhetor per 2005.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Tetor 2005 ne rreth 161,499 milione lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 147,441 milione, grantet 2,227 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 11,831 milione;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 108,739 milione lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 9,504 milione lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 29,198 milione leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të tetorit, rezulton se:

- TVSH 51,817 milionë lekë
- Tatimi mbi fitimin 15,217 milionë lekë
- Taksa doganore 10,821 milionë lekë
- Taksat nacionale 7,483 milionë lekë
- Akcizat 15,136 milionë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 3,971 milione lekë;

Financimi i deficitit

Deficiti prej 18.2 miliardë lekë, ne fund te muajit Tetor, u financua ne masen 76 përqind me financim të brendshëm dhe 24 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishin mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar - Qershor 2005 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem ne bilancin e pergjithshem, prej 14.8 milion dollare, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 184.7 milion dollare ;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 64.8 milion dollare ;

- sufiçit te Llogarise Financiare, prej 188.2 milion dollare ;
- bilanci negativ ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 53.6 milion dollare .



Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 184.7 milion dollare ishin nje:



- bilanc tregtar negativ prej 820.2 milion dollare ;
- deficit prej 55 milion dollare ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 85.3 milion dollare ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 605.4 milion dollare ne levizjet e transfertave dhe dergesave.

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investimeve direkte prej 125.3 milionë dollare,
- flukset negative të investime portofoli prej 63 milionë dollare
- flukset pozitive të kapitaleve të tjera prej 119.7 milionë dollare.

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Korrik 2005, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 217.9 milione dollare krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, duke rezultuar me ritme rritjeje me te ulta ne krahasim me periudhat e kaluara.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 80.4 milione usd, nderkohe qe mjetet valutore neto te Bankes se Shqiperise, jane rritur me 137.5 milione dollare.

Ne muajin korrik sistemi bankar rezulton me nje rritje prej 17.5 milionë dollaresh ne mjetet valutore neto, krahasuar me nje muaj me pare. Kontributin kryesor ne kete rritje e kane bankat e nivelit te dyte me nje rritje mujore prej 13.3 milion usd . Kjo rritje eshte ndikuar edhe nga rritja e flukseve hyrese te valutes se huaj gjate kesaj periudhe, duke ndikuar ne rritjen e depozitave ne valute. Ashtu si depozitat edhe kredite ne valute kanë shenuar rritje, por niveli i depozitimit në valute ka qenë me i larte duke krijuar mundesi per rritjen e mjeteve valutore neto te bankave të nivelit të dyte.

Banka e Shqiperisë ka rritur rezerven valutore neto me 4.2 milionë usd, duke arritur ne 1,199 milion usd . Kjo ka ardhur nga rritja e depozitave ne bankat e huaja si dhe nga ulja në zerin e detyrimeve ndaj FMN-së.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit korrik 2005 arriti ne 97.7 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 37.8 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 63 për qind. Krahasuar me nje muaj me pare kjo shenoi nje rritje te lehte prej 1.8 miliarde leke. Kredia ne leke, kahasuar me nje muaj me pare, u rrit

me 685 milion leke, duke arritur ne rreth 22.1 miliarde leke. Kontributi i saj ndaj rritjes vjetore të kredisë total nga 32 për qind që ishte në muajin qershor, arriti në 35 për qind.

Gjatë muajit korrik rritja e kredisë në lekë mendohet të ketë marrë shtytje nga ecuria pozitive e kredisë për individet.

Nga struktura e teprices se kredise sipas afateve verehet nje rritje e peshes se kredive afatgjata, te cilat arriten ne 33.8 perqind, nga 33.1 perqind qe ishte nje muaj me pare. Teprica e kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere 76.8 perqind te totalit te treprices se kredise.

Gjate ketyre viteve te fundit vihet re një angazhim ne rritje i bankave drejt kredise me afat maturimi mbi 1 vit, duke ulur ndjeshëm financimin e ekonomisë me kredi afatshkurtër. Megjithate kjo e fundit krahasuar me nje muaj me pare pesoi nje rritje te lehte ne peshe specifike ndaj totalit ne 34.4 perqind nga 33.7 perqind qe ishte nje muaj me pare.

Hyrja e bankes "Raiffeissen" ne tregun e kredidhenies, i ka nxitur bankat te tregohen me aktive ne tregun e kredise duke shfrytezuar mundesi te reja. Nje rol te rendesishem ne rritjen e vellimit te kredise afatgjate mendohet qe te kete luajtur edhe forcimi i marredhenieve midis bankave dhe klienteve te tyre, bizneseve dhe individeve. Ketyre te fundit po i kushtohet me shume vemendje nga bankat, sikurse konstatohet edhe nga rritja e vazhdueshme e portofolit te kredise per individet.

Forcimi i marrëdhënieve bankë – klientë, po rrit besimin e bankave për të investuar më shumë në aktivitetin kreditues, duke rritur rolin e tyre si ndërmjetës financiarë.

Megjithese sektori i tregtise vazhdon te mbetet mbizoteruese me rreth 19 perqind te totalit te pergjithshem te kredise, gjate kesaj periudhe te 2005 ajo ka shfaqur tendenca renese. Mbeshtetje me e madhe me kredi po i kushtohet sektoreve prodhues dhe blerjen e pasurive te paluajtshme. Nje zhvendosje e tille pasqyron tendencen e bankave per te ofruar produkte te reja, ne pershtatje me kerkesat e bizneseve dhe te individeve.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin korrik ka shenur nje rritje prej 0.63 perqind, karahasuar me muajin qershor '05. Kjo oferte kapi shifren rreth 545 miliardë lekë në fund të muajit korrik. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 11 perqind, duke shenuar nje rritje prej 7.50 pikesh perqindjeje kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor. Pershpejtimi i ritmit te rritjes se ofertes monetare i dedikohet rritjes me te larte te depozitave ne valute.

Niveli i parase jashte bankave eshte rritur me 0.2 miliarde leke ne krahasim me muajin dhjetor 2004. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 11 perqind. Rritja e theksuar e ketij treguesi gjate muajit korrik është favorizuar kryesisht nga faktore me ndikim të

përkohshëm si, rimbursimi i kreditoreve të firmave piramidale, perqendrimi i kerkeses per para te qeverise në periudhën e zgjedhjeve, dhe rritja e lartë e kredisë për ekonominë në lekë në muajin korrik.



	Korr 04	Gusht 04	Shtat 04	Tet 04	Nent 04	Dhje 04	Jan ,05	Shku 05	Mars 05	Prill 05	Maj 05	Qer 05	Korr 06
PJB/M3	26.4	26.6	25.9	25.9	26.0	27.2	25.8	25.4	24.8	24.8	24.5	25.1	25.4
PJB/Dep	35.9	36.2	34.9	35.0	35.2	37.4	34.8	34.0	33.0	33.0	32.5	33.5	34.0

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit korrik arriti ne 25.4 perqind duke shenuar nje rritje prej 0.4 perqind ne krahasim me muajin qershor.

Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin korrik arriten shifren prej 34 perqind duke pesurar nje rritje mujor prej 0.5 perqind.

Depozitat ne leke si perberesi kryesor i ofertes monetare, dhe depozitat ne valute te huaj, mbeten pothuajse te pandryshuara ne krahasim me nje muaj me pare me nje rritje te lehte perkatesisht me 0.2 perqind. Norma vjetore e rritjes se depozitave ne valute ne fund te muajit korrik arriti ne 26 perqind nga 17 perqind qe ishte ne fund te muajit dhjetor. Kjo ecuri e depozitave ne valute ka pasqyruar rritjen e efektit vjetor te kursit të këmbimit te lekut gjate periudhes janar – korrik.

Rritja e ofertes se parase prej 3.4 miliard leke eshte ndikuar ne masen me te madhe nga rritje e parase jashte bankave me 2.5 miliarde leke. Rënia e normave reale të interesit në nivelet minimale historike, nuk duket të ketë ndikuar në rritjen e këtij treguesi pertej efekteve të njohura sezonale.

Depozitat sipas Burimeve

Kjo tabelë tregon përbërjen e depozitave te cilat kontribuojnë në përkufizimet e ndryshme të ofertës së parasë (Tabela 15) sipas llojit të depozituesve.
Një shqyrtim i tabelës tregon se gjate muajit korrik 2005:

- Sektori i individeve, zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me 49 perqind, ndjekur nga sektori privat me 30 perqind dhe nga ndermarjet jofinanciare publike me 15.3 perqind.

- Individet si edhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 47 perqind dhe 40.7 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.3 përqind e totalit) dhe depozitave me afat në monedhe të huaj (me 88 përqind e totalit te depozitave;
- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 83.4 përqind) të depozitave totale prej 406.9 miliardë lekësh ne muajin korrik 2005. Ata ndiqen nga sektori privat (12 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (3.3 përqind) dhe autoritetet lokale (0.7 përqind). Institucionet financiare kontribuan me 0.60 për qind ne totalin e depozitave.



- Gjatë muajit korrik 2005, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 0.90 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave pa afat ne leke (4.94 miliard leke), depozitave me afat ne monedhe te huaj (1.91 miliard leke) dhe uljes se depozitave pa afat ne valute me (-1.6 miliarde leke) dhe depozitave me afat në lekë (- 4.34 miliardë lekë).

- Depozitat pa afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 5.2 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familiareve pesuan nje rrenie prej rreth 4.6 miliarde leke gjate muajit korrik.